

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e –II–
KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR

Procesverbal Nr. 82
nga mbledhja publike e mbajtur më **25.9.2007**
kryesuar nga **Rifat Krasniç**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

- | | | |
|------------|--------------------|--------------|
| 1. Rifat | KRASNIÇ | kryetar |
| 2. Lulzim | ZENELI | nënkryetar-I |
| 3. Jusuf | SUTAJ | |
| 4. Shaban | HALIMI | |
| 5. Zyhrrie | MALOKU | |
| 6. Berat | LUZHA | |
| 7. Sadudin | BERISHA | |
| 8. Afrim | ARZUALLXHIU | |
| 9. XHelal | CANZIBA | |
| 10. Fetah | BERISHA | |

Munguan :

- | | |
|-------------|-----------------------------------|
| 11. Gazmend | MUHAXHERI |
| 12. Selvije | HALIMI |
| 13. Goran | BOGDANOVIĆ -nënkryetar-II- |
| 14. | |

TË FTUARIT : nga MMPH (Jashar Kastrati, Tirana Baftiu, Nazmi Shkodra)

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit për Shitjen e banesave-vazhdim i shqyrtimit
3. Të ndryshme

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe konstatoi se lidhur me pikën 1 nuk ka vërejtje.

Shqyrtimi i Projektligjit për Shitjen e Banesave

Kryetari në fillim përshëndeti anëtarët e komisionit dhe të ftuarit duke iu përkujtuar mbledhjen e kaluar kur është kërkuar sqarime nga MMPH rreth titullarit të banesave që duhen të shiten.

Tirana Baftiu së pari reagoi për nenin 4 i cili u korrigjua në mënyrën e duhur dhe u fshi fjalia të cilën e ka potencuar Gazmend Muhaxheri në mbledhjen e kaluar.

Komisioni shqyrtoi projektligjin deri tek neni 19 bashkërisht me disa vërejtje teknike nga MMPH ndërsa kryetari njoftoi anëtarët e komisionit se **Lulzim Zeneli** ka pasur takim me zyrtarët e OSBE të cilët kanë kërkuar pak kohë nga komisioni derisa të përgatisin vërejtjet me shkrim lidhur me këtë projekt. Gjithashtu komisioni ka shqyrtuar vërejtjet nga ana e **Gani Kocit** nga tri propozimet e të cilit dy nuk u miratuan. Raporti me rekomandime do të hartohet me shkrim.

Të ndryshme

Sadudin Berisha njoftoi komisionin rreth kërkesës së kryesisë për rekomandime nga dy komisionet për ndërtimet ilegale nga ana e Qeverisë së Serbisë në Mitrovicën Veriore. I njëjti është anëtarë edhe në komisionin për legjislacion , ndaj njoftoi se komisioni për legjislacion konsideron se ky komision është funksionale për këto çështje e cila duhet të kujdeset për mbledhjen e të dhënave nga ministria përkatëse e cila duhet të sugjeroi rekomandimet e mundshme për këto ndërtime në Mitrovicën veriore.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Për mbledhjen e dt. 2.10.2007 në orën 11,00 të ftohet Ministri Ardian Gjini i cili do të sugjeroi komisionin për rekomandime eventuale të cilat i ka kërkuar kryesia e Kuvendit lidhur me ndërtimet ilegale nga ana e Qeverisë së Serbisë në Mitrovicën Veriore.

Pas elaborimit dhe sugjerimeve të ministrit , dhe pas shikimit të transkriptit të seancës plenare ku është diskutuar kjo pikë, Komisioni do të nxjerr rekomandimet eventuale të cilat janë kërkuar nga Kryesia e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryetari i Komisionit,
Rifat Krasniç

